VENDIM
Nr. 7, datë 28.1.2026

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Fiona Papajorgji	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Asim Vokshi	anëtar;
Sandër Beci	anëtar,

me sekretare Anjeza Puka, në datën 23.12.2025 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 8 (I) 2025 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ilir Beqaj, përfaqësuar nga avokat Ermal Yzeiraj, me akt përfaqësimi.

SUBJEKT I INTERESUAR:

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, përfaqësuar nga prokurorja Elida Kaçkini, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 65, datë 3.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 73, datë 6.7.2024, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 32 (87-2024-228), datë 7.8.2024, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2025-20 (1), datë 14.1.2025, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të subjektit të interesuar.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, 134, pika 1, shkronja "i", dhe 134, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë *(Kushtetuta);* neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*) dhe neni 4 i Protokollit nr. 7 të saj; nenet 27, 49, pika 3, shkronja "e", 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar *(Ligji Organik i Gjykatës).*

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit Ilir Beqaj (*kërkuesi*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar *(Prokuroria e Posaçme)*, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi nga viti 2021 ka qenë i ngarkuar me detyrën e drejtorit të Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës *(SASPAC).* Në ushtrim të këtij funksioni,

kërkuesi ka pasur si detyrë të kryente detyrën e Koordinatorit Kombëtar për Instrumentin e Paraaderimit të Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian lidhur me ndihmën e huaj për programe dhe projekte zhvillimore. Ai dyshohet se, në kundërshtim me ligjin, nuk ka deklaruar pasuri të cilat nga hetimet e Prokurorisë së Posaçme rezultojnë në pronësinë e tij. Gjithashtu, kërkuesi dyshohet se në bashkëpunim ka siguruar produkte nga një shoqëri ku ortake është bashkëshortja e tij, duke i fshehur nëpërmjet pagesave sikur janë bërë nga një tjetër kompani. Edhe eventet e organizuara në restorantin "G.", ku dyshohet se ka interesa pasurorë kërkuesi, paguheshin nëpërmjet faturave të lëshuara nga subjekte të tjera për të mos ekspozuar këtë aktivitet dhe lidhjen me të. Për këto fakte ai dyshohet se në cilësinë e drejtorit të SASPAC-ut ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe detyrën e tij, duke realizuar përfitime të paligjshme.

2. Lidhur me këto dyshime, kërkuesi dhe disa persona të tjerë janë proceduar penalisht nga Prokuroria e Posaçme në kuadër të procedimit penal nr. 190, datë 6.9.2023, të regjistruar për veprat penale "Mashtrimi", të kryer në bashkëpunim me pasoja të rënda, "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera ose ankande publike", të kryer në bashkëpunim, "Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike", të kryer në bashkëpunim, "Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë", të kryer në bashkëpunim, "Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike" dhe "Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklarim", të parashikuara nga nenet 143, paragrafët 2 dhe 3, 244, 258, paragrafi 2 e 25, 259, paragrafi 2 e 25, 257/a, paragrafi 2 dhe 260 e 25, të Kodit Penal (*KP*). Ajo prokurori ka regjistruar edhe emrat e autorëve të dyshuar të këtyre veprave, ndër të tjerë, edhe emrin e kërkuesit në datën 18.6.2024.

3. Objekt i hetimit të Prokurorisë së Posaçme janë veprimet e kryera nga kërkuesi dhe të bashkëpandehurit gjatë viteve 2022-2023, që lidhen me disa procedura prokurimi, të cilat dyshohet se janë fiktive dhe në kundërshtim me rregullat e aplikueshme për prokurimet me fonde të Bashkimit Evropian *(BE),* referuar nenit 5, shkronja "c", të ligjit nr. 37/2015, "Për ratifikimin e marrëveshjes kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA II)". Gjithashtu, në kuadër të këtij procedimi, ekziston dyshimi se shoqëri të kontraktuara nga SASPAC-u për zhvillime eventesh, i kanë realizuar shërbimet në restorantin "G." tek i cili dyshohet se ka interesa pasurorë edhe kërkuesi. Po ashtu, edhe një automjet i përdorur nga kërkuesi dyshohet se është në pronësi të tij. Të dyja këto pasuri që dyshohet se janë në pronësi të kërkuesit nuk janë deklaruar sipas ligjit nga ana e tij.

4. Në vijim, Prokuroria e Posaçme i ka kërkuar gjykatës caktimin ndaj personave nën hetim të masave të sigurimit personal me karakter shtrëngues, ku për kërkuesin ka kërkuar masën "Arresti në burg", si i dyshuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 143, paragrafët 2 dhe 3, 257/a, paragrafi 2, 258, paragrafi 2 e 25, si edhe 260 dhe 25 të KP-së. Mbi këtë kërkesë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), me vendimin nr. 65, datë 3.7.2024, ka vendosur caktimin ndaj kërkuesit të masës "Arresti në burg". Kjo masë sigurimi është ekzekutuar në datën 4.7.2024 dhe, në vijim, në përputhje me nenin 248 të Kodit të Procedurës Penale (*KPP*), GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka marrë në pyetje kërkuesin e arrestuar, me qëllim verifikimin e kushteve dhe kritereve të caktimit të masës, si dhe të nevojave të sigurimit. Në përfundim, me vendimin nr. 73, datë 6.7.2024, ajo gjykatë, ndër të tjera, ka vendosur vazhdimin e zbatimit të masës "Arresti në burg" ndaj kërkuesit. Kundër këtij vendimi, sikundër edhe atij për caktimin e masës së sigurimit, kërkuesi ka paraqitur ankim.

5. Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar *(GJKKO-ja e Apelit)*, me vendimin nr. 32 (87-2024-228), datë 7.8.2024, ka vendosur miratimin e vendimeve të GJKKO-

së së Shkallës së Parë për caktimin dhe vazhdimin e zbatimit të masës së sigurimit personal "Arresti në burg" ndaj kërkuesit. Ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e kërkuesit, me vendimin nr. 00-2025-20 (1), datë 14.1.2025, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 32 (87-2024-228), datë 7.8.2024 të GJKKO-së së Apelit.

6. Në datën 25.6.2025 kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 1.7.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 25.9.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

7. Në datën 30.10.2025 kërkuesi ka paraqitur kërkesë për përshpejtimin e gjykimit, me argumentin se ai kishte shfaqur probleme shëndetësore dhe se për kurimin e tyre i nevojitej një regjim strikt që nuk mund të zbatohej në ambientet e paraburgimit. Mirëpo Gjykata e kishte caktuar ndërkohë datën e seancës plenare, duke i dhënë përparësi shqyrtimit të çështjes, me nismën e saj, në përputhje me nenin 28 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së, pra duke mos iu referuar kohës së regjistrimit, por rëndësisë të së drejtës kushtetuese.

8. Në vijim, në datën 4.11.2025 një gjyqtar, pas njohjes me aktet, ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes dhe Mbledhja e Gjyqtarëve, me anë të vendimit nr. 27, datë 4.11.2025, ka vendosur pranimin e kësaj kërkese.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i janë cenuar:

9.1. *E drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës* në drejtim të *së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit,* pasi GJKKO-ja e Apelit nuk ka aplikuar në arsyetimin e saj "kriteret e veçanta" të përcaktuara në nenin 230, pika 1, të KPP-së. Në këtë kuadër, të dyja kriteret e përdorura nga gjyqtari i GJKKO-së së Apelit, respektivisht rrezikshmëria e veprave penale dhe numri i tyre, nuk përkojnë me ato të përcaktuara në pikën 1 të nenit 230 të KPP-së, ndaj konsiderohen ekstraligjore. Të dyja gjykatat e faktit nuk kanë arsyetuar as për rrezikshmërinë e kërkuesit dhe as pse ai rrezikonte të largohej, duke i bërë këto vendime arbitrare dhe jo ligjore. Ato gjykata nuk kanë mbajtur parasysh faktin se kërkuesi hetohej edhe për një çështje tjetër nën masën e sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", masë të cilën as e kishte ankimuar, madje kishte treguar disponibilitet të plotë karshi hetimeve. Gjithashtu, si gjykatat e faktit nuk kanë arsyetuar në lidhje me kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit "Arresti në burg" me "Garancia pasurore" dhe një masë më të lehtë sigurimi. Të metat në arsyetim nuk u riparuan as nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili e shndërroi rastin e kërkuesit në një rast përjashtimor nga praktika e vet kolegjit, si dhe nuk iu dha përgjigje e arsyetuar të gjitha pretendimeve të paraqitura prej tij në rekurs.

9.2. *Liria personale, e sanksionuar* në nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës dhe në nenin 5 të KEDNJ-së, pasi gjyqtari i vetëm në arsyetimin e vendimit të GJKKO-së së Apelit ka vepruar në tejkalim të kompetencave të tij funksionale, duke cenuar pavarësinë dhe kompetencat e prokurorit të çështjes, si dhe duke përvetësuar kompetencat që i takojnë gjyqtarit të seancës paraprake, për shkak të shtimit të një vepre penale, "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer në bashkëpunim dhe të parashikuar nga neni 186, paragrafi 3, i KP-së. Kjo vepër penale e shtuar dhe e përdorur nga gjyqtari i GJKKO-së së Apelit nuk ishte objekt hetimi nga ana e prokurorisë, duke mos qenë e shënuar në regjistrin e saj, nuk citohej në kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës së sigurisë ndaj kërkuesit, si dhe nuk përmendej e as ishte diskutuar në vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe as ishte objekt ankimi. Kjo vepër e shtuar ka ndikuar në vlerësimin e gjykatës në lidhje me përshtatshmërinë dhe proporcionalitetin e masës së sigurimit personal dhe heqjen e paligjshme

të lirisë personale ndaj kërkuesit, duke u përdorur edhe në arsyetimin e GJKKO-së së Apelit. Edhe përcaktimet e nenit 287 të KPP-së, të sjella si argument nga Prokuroria e Posaçme, nuk kanë asnjë lidhje me detyrat e gjyqtarit të hetimit paraprak, kjo edhe në kushtet kur gjyqtari i apelit vetëm kontrollon veprimet e gjyqtarit të hetimit paraprak, atij të shkallës së parë. Ky vendim nuk është ndrequr as nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili në raste të ngjashme kishte prishur vendimin e gjykatës së apelit.

9.3. *Parimi i sigurisë juridike, i garantuar nga neni 4 i Kushtetutës,* pasi Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka devijuar nga praktika e tij e mëparshme dhe e afërt, ku në disa raste të ngjashme, kur gjyqtari kishte tejkaluar kompetencat duke shtuar vepra penale, ai Kolegj kishte prishur vendimin e apelit, duke e kthyer çështjen për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Pikërisht në këtë linjë është edhe mendimi pjesërisht kundër i kryetarit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që vendimi në vetvete i ka cenuar kërkuesit pritshmëritë e ligjshme lidhur me vendimmarrjen.

9.4. *Parimi i proporcionalitetit i lidhur me lirinë personale,* pasi vendimmarrja e gjykatave të zakonshme nuk ka pasqyruar në mënyrë të plotë shkaqet që i kanë orientuar ato në marrjen e vendimeve dhe arsyet se përse caktimi i masës më të rëndë të sigurimit personal është vlerësuar i nevojshëm. Mospërcaktimi nga ana e tyre e rrezikshmërisë së kërkuesit, duke u fokusuar vetëm te rrezikshmëria e veprave penale, si dhe shtimi në mënyrë të paligjshme nga GJKKO-ja e Apelit e një vepre penale, kanë ndikuar direkt në masën e sigurimit të kërkuesit, duke e bërë atë jo të ligjshme, jo të përshtatshme dhe joproporcionale. Po ashtu, Gjykata e Lartë dhe ajo e shkallës së parë kanë vlerësuar se ka tre rreziqe ose ndryshe nevoja sigurimi, ndërkohë që gjyqtari i apelit, megjithëse konkludon për një rrezik, vetëm atë të largimit, sërish e shikon masën e sigurimit personal "Arresti në burg" si proporcionale, njësoj me shkallën e parë.

10. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar si vijon:

10.1. Pretendimi për cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor nuk qëndron për faktin se nuk ka pasur shkelje të neneve respektive që garantojnë mbrojtjen konventore dhe kushtetuese, pasi vendimet e GJKKO-së së Apelit dhe Kolegjit Penal i kanë dhënë përgjigje shteruese kërkuesit lidhur me domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e masës së sigurimit.

10.2. Pretendimi për cenimin e lirisë personale, i ngritur nga kërkuesi, nuk qëndron dhe ky fakt është përforcuar nga vendimmarrja e gjykatave të zakonshme, të cilat kanë arsyetuar mjaftueshëm për nevojën, domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e masës së sigurimit personal. Pretendimet për rolin dhe shkeljet e gjyqtarit të apelit, se ai ka shtuar pa të drejtë veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", janë të pabazuara, si dhe pa efekt e rol në caktimin e masës së sigurimit personal "Arresti në burg", që është vendosur pas analizës së kryer për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në kryerjen edhe të tri veprave të tjera penale. Gjithashtu, arsyetimi i dhënë nga GJKKO-ja e Apelit është i saktë dhe përputhet me përcaktimet e KPP-së. Po ashtu, në pikën 2 të nenit 287 të KPP-së përcaktohet se gjatë hetimeve paraprake mund të ndodhë që të ketë ndryshim të cilësimit juridik ose të ndonjë rrethane të kryerjes së veprës penale, atëherë prokurori urdhëron pasqyrimin e tyre në shënimet e bëra sipas pikës 1 të të njëjtit nen. Kjo dispozitë është e lidhur me hetimet paraprake dhe gjen zbatueshmëri nga subjektet procedurale pjesëmarrëse në hetimet paraprake, konkretisht gjyqtari i hetimeve paraprake dhe prokurori, ndaj dhe ky orientim nuk vlerësohet në tejkalim të kompetencës së gjyqtarit.

10.3. Pretendimi që lidhet me proporcionalitetin e masës nuk qëndron, pasi, sikurse me të drejtë kanë arsyetuar edhe gjykatat e zakonshme, kjo masë është në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal dhe në përshtatje me nevojat e sigurimit dhe rëndësinë e faktit penal për të cilin kërkuesi dyshohet, si dhe me sanksionet që ligji parashikon për ato vepra. Gjithashtu, gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë shteruese lidhur me rrezikshmërinë e veprave për

të cilat procedohet, detyrën që kërkuesi mbante dhe rrezikun e përsëritjes së tyre, të cilat tregojnë për një veprimtari të shtrirë në kohë dhe një mënyrë perceptimi të ushtrimit të detyrës që bie ndesh me ligjin dhe në favor të interesave pasurorë personalë. Për këto arsye, masa më e lehtë e sigurimit e kërkuar nga ai, "Garancia pasurore", ka qenë e papërshtatshme dhe joproporcionale. Nga të tria gjykatat e zakonshme është respektuar kriteri kushtetues i dyshimit të arsyeshëm si kusht *sine qua non* për justifikimin e lirisë personale.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

11. Çështja e legjitimimit *(locus standi)* është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi kushtetues.

13. Një kriter tjetër paraprak është *shterimi i mjeteve juridike efektive,* që përcaktohet nga neni 131, pika 1, shkronja "f", i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja "a", i Ligjit Organik të Gjykatës. Shterimi i mjeteve juridike ka të bëjë me funksionin subsidiar të mbrojtjes kushtetuese, që mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor. Megjithatë, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore për caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg, duke arsyetuar se karakteri i këtij vendimi, që lidhet me heqjen e lirisë së individit, si përjashtim, e bën atë një vendim përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 17, datë 13.3.2024; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Lidhur me këtë kriter, Gjykata çmon se kërkuesi ka paraqitur ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët dhe pasi ka shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, për caktimin ndaj tij të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues "Arresti në burg", përpara se t'i drejtohej Gjykatës.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit *(shih vendimin nr. 42, datë 19.9.2023, të Gjykatës Kushtetuese)*.

16. Në çështjen konkrete, Gjykata evidenton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 14.1.2025, kurse kërkesa është paraqitur në Gjykatë më 25.6.2025. Nga ana e kërkuesit, bashkëlidhur ankimit kushtetues individual, është paraqitur *e-mail*-i i dërguar nga Gjykata e Lartë që i ka komunikuar vendimin e saj në datën 25.3.2025, çka provon se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor, për pasojë kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*.

17. Për sa i takon legjitimimit *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi, në thelb, ka pretenduar cenimin e lirisë personale për shkak të caktimit ndaj tij të masës së sigurimit personal "Arresti në burg", ndërsa ka kundërshtuar vendimet e gjykatave të zakonshme, duke pretenduar edhe cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe parimit të proporcionalitetit dhe atë të sigurisë juridike.

18. Për sa i përket pretendimit për cenimin e lirisë personale, Gjykata vëren se kërkuesi e ka argumentuar në drejtim të standardit të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova dhe parimit të proporcionalitetit. Nga ana tjetër, kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor edhe në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pikërisht në lidhje me dy aspektet e lirisë personale të pretenduar si të shkelur. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pohuar se liria personale ka dy anë: atë substanciale, që garantohet nga neni 27 i Kushtetutës dhe atë procedurale, që garantohet nga neni 28 i lidhur me nenin 42 të Kushtetutës. Në rastet e kontrollit të vendimeve që caktojnë masat e sigurimit personal, ajo i trajton pretendimet e parashtruara në ankimin kushtetues në drejtim të të drejtave substanciale, ndërsa pretendimet që kanë të bëjnë me të drejtën për proces të rregullt ligjor trajtohen si aspekte procedurale të së drejtës substanciale të pretenduar të cenuar. Në këtë kuptim, ajo ndalet në aspekte të veçanta të së drejtës për proces të rregullt ligjor, për sa ato mund të ndikojnë drejtpërdrejt në të drejtën substanciale në vetvete *(shih vendimet nr. 86, datë 20.12.2024; nr. 81, datë 21.11.2024; nr. 29, datë 16.4.2024, të Gjykatës Kushtetuese)*.

19. Për sa më lart, duke vlerësuar se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale bën pjesë në juridiksionin kushtetues, Gjykata në vijim do ta analizojë atë në aspektin substancial në drejtim të: i. standardit të dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova; dhe ii. parimit të proporcionalitetit.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e lirisë personale

B.1.1. Në lidhje me standardin e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova

20. Kërkuesi ka pretenduar se i është cenuar liria personale, e sanksionuar në nenet 27 dhe 28 të Kushtetutës dhe në nenin 5 të KEDNJ-së, pasi gjyqtari i vetëm në arsyetimin e vendimit të GJKKO-së së Apelit ka vepruar në tejkalim të kompetencave të tij funksionale, duke cenuar pavarësinë dhe kompetencat e prokurorit të çështjes, si dhe duke përvetësuar kompetencat që i takojnë gjyqtarit të seancës paraprake, për shkak të shtimit të një vepre penale, "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer në bashkëpunim dhe të parashikuar nga neni 186, paragrafi 3, i KPP-së. Sipas tij, kjo vepër penale e shtuar dhe e përdorur nga gjyqtari i GJKKO-së së Apelit nuk ishte objekt hetimi nga ana e Prokurorisë së Posaçme, duke mos qenë shënuar në regjistrin e saj, nuk citohej në kërkesën e prokurorisë për caktimin e masës së sigurisë ndaj kërkuesit, si dhe nuk përmendej e as ishte diskutuar në vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë dhe as ishte objekt ankimi. Sipas kërkuesit edhe përcaktimet e nenit 287, të sjella si argument nga Prokuroria e Posaçme, nuk kanë asnjë lidhje me detyrat e gjyqtarit të hetimit paraprak, kjo edhe në kushtet kur gjyqtari i apelit vetëm kontrollon veprimet e gjyqtarit të hetimit paraprak, atij të shkallës së parë.

21. Kërkuesi, gjithashtu, ka pretenduar edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike, për shkak se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka devijuar nga praktika e tij e mëparshme dhe e afërt, ku në disa raste të ngjashme, kur gjyqtari kishte tejkaluar kompetencat duke shtuar vepra penale, ai Kolegj

kishte prishur vendimin e apelit, duke e kthyer çështjen për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues. Sipas kërkuesit në këtë linjë është edhe mendimi pjesërisht kundër i kryetarit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që vendimi në vetvete i ka cenuar atij pritshmëritë e ligjshme lidhur me vendimmarrjen.

22. Subjekti i interesuar ka prapësuar se pretendimi për cenimin e lirisë personale nuk qëndron, duke argumentuar se pretendimet për rolin dhe shkeljet e gjyqtarit të apelit, se ai ka shtuar pa të drejtë veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", janë të pabazuara, si dhe pa efekt e rol në caktimin e masës së sigurimit personal "Arresti në burg", që është vendosur pas analizës së kryer për ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm në kryerjen edhe të tri veprave të tjera penale. Gjithashtu, arsyetimi, i cili është dhënë nga GJKKO-ja e Apelit, është i saktë dhe përputhet me përcaktimet e KPP-së. Po kështu, në pikën 2 të nenit 287 të KPP-së përcaktohet se gjatë hetimeve paraprake mund të ndodhë që të ketë ndryshim të cilësimit juridik ose të ndonjë rrethane të kryerjes së veprës penale, atëherë prokurori urdhëron pasqyrimin e tyre në shënimet e bëra sipas pikës 1 të të njëjtit nen. Sipas subjektit të interesuar, kjo dispozitë është e lidhur me hetimet paraprake dhe gjen zbatueshmëri nga subjektet procedurale pjesëmarrëse në hetimet paraprake, konkretisht gjyqtari i hetimeve paraprake dhe prokurori, ndaj edhe ky orientim nuk vlerësohet në tejkalim të kompetencës së gjyqtarit. Nga të tria gjykatat e zakonshme është respektuar kriteri kushtetues i dyshimit të arsyeshëm si kusht *sine qua non* për justifikimin e lirisë personale. Subjekti i interesuar nuk ka prapësuar lidhur me pretendimin e kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike.

23. Neni 27 i Kushtetutës parashikon se askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj (paragrafi 1), ndërsa liria e personit mund të kufizohet kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale (paragrafi 2, shkronja "c"). Kurse neni 28 i Kushtetutës parashikon se personi, të cilit i është hequr liria sipas nenit 27, paragrafi 2, nënparagrafi c, duhet të dërgohet brenda 48 orëve përpara gjyqtarit, i cili vendos paraburgimin ose lirimin e tij jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së dokumenteve për shqyrtim (paragrafi 2) dhe se i paraburgosuri ka të drejtë të ankohet kundër vendimit të gjyqtarit (paragrafi 3).

24. Gjykata ka pohuar se qëllimi kryesor i nenit 27 të Kushtetutës është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustifikuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një "shoqëri demokratike". Kërkesa "dyshime të arsyeshme" për kryerjen e veprës penale që justifikon kufizimin e lirisë personale të individit, nënkupton ekzistencën e fakteve ose të informacioneve që arrijnë të bindin edhe një vëzhgues të jashtëm se personi i dyshuar mund të ketë kryer veprën penale, të cilat nuk është e nevojshme të jenë në të njëjtin nivel si ato për të cilat nevojitet ngritja e akuzës ose justifikimi i dënimit penal, që i përkasin një shkalle të mëvonshme të procesit të hetimit penal.

25. Po sipas Gjykatës, në zbatim të delegimit të nenit 27 të Kushtetutës, rastet dhe procedurat e kufizimit të lirisë personale për shkak të veprave penale janë parashikuar nga KPP-ja, ku në rastin e caktimit të masës së sigurimit, neni 228, pika 1, i saj, në përputhje me nenin 27, pika 2, shkronja "c", të Kushtetutës, përcakton si kusht të domosdoshëm *(sine qua non)* ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova se individi ka kryer një vepër penale (*shih vendimet nr. 86, datë 20.12.2024; nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 19, datë 4.4.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Mosbërja e një hetimi të vërtetë nga ana e autoriteteve për faktet e çështjes, për të verifikuar nëse kufizimi i lirisë është bërë mbi bazën e një dyshimi të arsyeshëm, do të përbënte cenim të nenit 27 të Kushtetutës. Për të vlerësuar nëse është respektuar standardi i dyshimit të arsyeshëm që kërkohet për arrestimin e një individi, mbahet në konsideratë konteksti i përgjithshëm i fakteve të çështjes, duke përfshirë këtu edhe statusin/personalitetin e kërkuesit, kronologjinë e ngjarjeve, mënyrën në të cilën është kryer hetimi dhe sjelljen e autoriteteve (*shih vendimin nr. 19, datë 21.3.2024, të Gjykatës Kushtetuese)*.

27. Referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, në rastin në shqyrtim, Gjykata vlerëson të analizojë faktin nëse gjyqtari i vetëm, nëpërmjet arsyetimit të vendimit të GJKKO-së së Apelit, ka vepruar në tejkalim të kompetencave të tij, në kuadër të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm, duke i cenuar kërkuesit lirinë personale. Po ashtu, Gjykata do të vlerësojë edhe nëse nga vendimmarrja e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është cenuar ose jo parimi i sigurisë juridike.

28. Gjykata vëren se ndaj kërkuesit Prokuroria e Posaçme, pas regjistrimit të procedimit penal nr. 190, datë 6.9.2023, për veprat penale të parashikuara nga nenet 143, paragrafët 2 dhe 3, 257/a, paragrafi 2, 258, paragrafi 2 e 25, si dhe 260 dhe 25 të KP-së, ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit personal "Arrest në burg", masë kjo që është caktuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë e më tej gjatë marrjes në pyetje është konfirmuar. Ndërkohë, masa e sigurimit është miratuar nga GJKKO-ja e Apelit, ndërsa Gjykata e Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të apelit.

29. GJKKO-ja e Shkallës së Parë, në të dyja vendimet e saj, atë lidhur me caktimin e masës së sigurimit e më tej atë të marrjes në pyetje të kërkuesit, ka arsyetuar se, referuar provave të paraqitura nga Prokuroria e Posaçme, ekzistojnë të dhëna që krijojnë dyshimin e arsyeshëm se kërkuesi ka kryer shumicën e veprave penale për të cilat dyshohet. Në lidhje me kushtin e dyshimit të arsyeshëm, ajo gjykatë ka mbajtur qëndrimin se për caktimin nga ajo të masës së sigurimit, dyshimi bazohej në analizën e veprimtarisë të kërkuesit dhe të personave të tjerë nën hetim në lidhje me shkeljet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës. Ajo gjykatë, për sa i takon kualifikimit penal të veprimeve për të cilat kërkuesi dyshohet, ndërsa i ka konsideruar të drejta kualifikimet e bëra nga Prokuroria e Posaçme për dyshimin për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 143, paragrafët 2 dhe 3, 257/a, paragrafi 2, dhe 258, paragrafi 2 e 25, të KP-së, ka vlerësuar se nuk ekziston dyshimi i arsyeshëm i mbështetur në prova se ai ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 260 dhe 25 i KP-së.

30. Në vijim, masa e sigurimit ndaj kërkuesit i është nënshtruar kontrollit nga GJKKO-ja e Apelit, e cila, pasi ka marrë në shqyrtim ankimin e kërkuesit, e ka vlerësuar të drejtë vendimin e GJKKO-së së Shkallës së Parë. Ajo gjykatë i ka konsideruar të bazuara vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë dhe pasi i ka rimarrë në analizë provat, ka konkluduar se nga tërësia e tyre ekziston dyshimi i arsyeshëm se kërkuesi i ka kryer veprat penale për të cilat dyshohet. Gjykata konstaton se, ndër të tjera, GJKKO-ja e Apelit, gjatë fazës së analizës së ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm ndaj kërkuesit, ka vlerësuar se përveç dyshimit të arsyeshëm për konsumimin e veprës penale "Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera ose ankande publike", të kryer në bashkëpunim ndërmjet kërkuesit dhe një tjetër personi nën hetim, të parashikuar nga nenet 258, paragrafi 2, dhe 25 të KP-së, në këtë rast ekziston edhe dyshimi i arsyeshëm për konsumimin e elementeve të veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 186, paragrafi 3, dhe 25 të KP-së. Kjo vepër e fundit, arsyeton ajo gjykatë, është kryer në bashkëpunim nga kërkuesi, në rolin e titulluarit të autoritetit kontraktor, i cili ka nënshkruar të gjitha urdhrat që kishin të bënin me një procedurë prokurimi disa muaj më pas datës që ato mbanin, duke pasqyruar fakte të pavërteta lidhur me kohën e zhvillimit të tyre, komunikimin e tyre subjekteve pjesëmarrëse në procedurë, si dhe nënshkrimin në emër të tyre të ofertave.

31. Çështja është shqyrtuar edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi rekursin e kërkuesit, i cili ka arsyetuar se vendimet e gjykatave të faktit kanë disponuar drejt lidhur me caktimin e masës së sigurisë, duke u dhënë përgjigje të argumentuara dhe ezauruese të gjitha pretendimeve të kërkuesit. Ai kolegj ka vlerësuar se lidhur me ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, gjykatat e faktit kanë verifikuar mjaftueshëm e më tej kanë arsyetuar ekzistencën e provave, rrethanave të faktit dhe elementet e mjaftueshme juridike që provonin se kërkuesi mund të kishte kryer veprat për të cilat dyshohej. Ai kolegj, për sa u takon pretendimeve të kërkuesit se gjykata e apelit, në kundërshtim me kompetencat e saj, kishte shtuar veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", të

kryer në bashkëpunim, ka arsyetuar se në kushtet kur as Prokuroria e Posaçme, as GJKKO-ja e Shkallës së Parë nuk ka konkluduar në ekzistencën e kësaj vepre penale, ky pretendim nuk përbën shkak për të cenuar vendimmarrjen e apelit. Po ashtu, ajo gjykatë ka arsyetuar se mënyra sesi ka kualifikuar faktin objekt procedimi ose ka vlerësuar plotësinë e hetimeve paraprake gjykata e apelit, gjatë shqyrtimit të ankimit të palëve për masën e sigurimit personal, është shprehje e pavarësisë së saj në vlerësimin e rëndësisë së faktit, mbështetur në provat e marra dhe ligjin e zbatueshëm dhe, ndryshe nga sa pretendohet në rekurs, nuk përbën tejkalim të kompetencës së gjyqtarit të hetimit paraprak. Kolegji Penal ka vlerësuar se është e drejtë, por njëkohësisht edhe detyrë e gjykatës që, në bazë të provave të ofruara nga palët, të përcaktojë se cila është vepra penale e kryer nga i dyshuari. Kjo për arsye se masa e sigurimit e caktuar duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me rëndësinë e faktit penal dhe kësisoj gjykata do të gabonte në caktimin e masës më të përshtatshme të sigurimit, nëse këtij fakti nuk do t'i jepte një cilësim juridik të drejtë (qoftë më të lehtë ose më të rëndë). Nga ana tjetër, edhe prokurori, si organ që ushtron ndjekjen penale, përfaqëson akuzën në gjyq dhe drejton e kontrollon hetimet paraprake, në ushtrimin e funksioneve të tij është i pavarur, çka do të thotë se, pavarësisht kualifikimit që i bën faktit gjyqtari i hetimit paraprak, në funksion të zgjidhjes sa më të drejtë të kërkesës që është parashtruar përpara tij, prokurori, në përfundim të hetimeve paraprake, nuk ka asnjë pengesë që në konformitet me nenet 327 dhe 331 të KPP-së, kur vlerëson të ushtrojë ndjekjen penale ndaj personit të hetuar, t'i japë një cilësim juridik të pavarur faktit penal për të cilin procedohet.

32. Gjykata vlerëson se GJKKO-të e faktit dhe Gjykata e Lartë, në caktimin e masës së sigurimit personal të arrestit në burg ndaj kërkuesit, me të drejtë kanë vlerësuar se ekzistonin kushtet për vendosjen e saj, në fazat fillestare të hetimit. Gjithashtu, të tria gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar mjaftueshëm për faktet që kanë shërbyer si bazë për caktimin e masës së sigurimit personal, ndërkohë që pretendimet e kërkuesit të rrëzuara nga ato lidhen me themelin e çështjes dhe jo me këtë fazë të procedimit.

33. Gjykata konstaton se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka arsyetuar mjaftueshëm edhe në lidhje me pretendimin e kërkuesit për shtimin nga ana e GJKKO-së së Apelit të veprës penale "Falsifikimi i dokumenteve", të kryer në bashkëpunim. Me të drejtë ajo gjykatë ka argumentuar se pavarësia e organit të akuzës jep garanci të mjaftueshme lidhur me dhënien e një cilësimi juridik të pavarur faktit penal për të cilin procedohet në momentin e dërgimit të çështjes për gjykim, ndërkohë që është detyrë e gjykatës dhe shprehje e pavarësisë së saj që të përcaktojë saktë veprën e kryer nga i dyshuari, për faktin se masa e sigurimit personal duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me rëndësinë e faktit penal dhe në konformitet me kriterin e përcaktuar në pikën 2 të nenit 229 të KPP-së, duke bërë që ajo të gabojë në caktimin e masës nëse nuk i jep faktit një cilësim juridik të drejtë. GJKKO-ja e Apelit nuk e ka rënduar pozitën e kërkuesit, por ka vlerësuar në mënyrë autonome rëndësinë e fakteve konform natyrës së veprave penale për të cilat ai dyshohet . Arsyetimi i gjykatës në drejtim të nevojave të sigurimit personal nuk përbën rëndim të pozitës të të pandehurit, pasi është organi i akuzës ai që vlerëson gjatë hetimit paraprak se për cilat vepra penale do të ngrejë përfundimisht akuzë.

34. Në këtë pikë, Gjykata vë në dukje se shtimi dhe ndryshimi i akuzës janë veprime procedurale formale të cilat kryhen nga organi procedues (prokurori ose gjykata) pasi individi merr cilësinë e të pandehurit me aktin e njoftimit të akuzës nga prokurori, në të cilin, në përputhje me nenin 34 të KPP-së, tregohen të dhënat e mjaftueshme. Në këtë kuptim, dhe për sa kohë gjykata e apelit nuk ka zgjeruar faktin penal të paraqitur nga prokuroria në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, është e qartë që vlerësimi i saj për ekzistencën e elementeve të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve për faktin e paraqitur nga prokurori nuk përbën ngritje të një akuze të re nga gjykata. Në thelb, ai përbën vlerësim të gjykatës të nevojave të sigurimit, që kërkon, ndër të tjera, të analizohet në mënyrë konkrete rëndësia e faktit penal. Duke u bazuar tek arsyetimi i

gjykatave të zakonshme, Gjykata çmon se sjellja e dyshuar e kërkuesit, në mënyrë të arsyeshme, mund të përfshihet nën veprat penale për të cilat dyshohet, nëse do të vërtetohet kryerja e tyre.

35. Në këndvështrim të sa më lart dhe duke mbajtur parasysh standardet e sipërpërmendura, Gjykata vëren se kufizimi i lirisë personale të kërkuesit është vendosur me vendim gjyqësor, bazuar në dyshime të arsyeshme për kryerjen prej tij të veprave penale për të cilat dyshohet dhe sipas procedurave të parashikuara nga ligji. Dyshimi konsiderohet i arsyeshëm për kufizimin e lirisë së tij personale, pasi është bazuar në fakte dhe informacione, të cilat i kanë krijuar bindjen gjykatave të zakonshme se ekziston një lidhje objektive midis personit të dyshuar dhe veprave penale për të cilat dyshohet.

36. Gjykata vëren se kërkuesi, në kuadër të kushtit të dyshimit të arsyeshëm, ka pretenduar edhe cenimin e parimit të sigurisë juridike, me argumentin se Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka devijuar nga praktika e tij e mëparshme dhe e afërt, ku në disa raste të ngjashme, në vendimet e tij nr. 00-2024-934, datë 23.5.2024, dhe nr. 00-2024-1588 (232), datë 26.9.2024, kur gjyqtari kishte tejkaluar kompetencat duke shtuar vepra penale, ai Kolegj kishte prishur vendimet e apelit, duke i kthyer çështjet për rigjykim në atë gjykatë, me tjetër trup gjykues.

37. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, gjatë shqyrtimit të ankimeve për lirinë personale, ka pohuar se parimi i sigurisë juridike mund të cenohet në rast se gjykatat vendase bëjnë përjashtime në jurisprudencën e tyre, të cilat bien ndesh me formulimin e dispozitave ligjore të zbatueshme, ose nëse bëjnë një interpretim të gjerë që mohon garancitë procedurale të parashikuara me ligj (*shih Aydın Sefa Akay kundër Turqisë, datë 23.4.2024, § 115).*

38. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, në rastin konkret Gjykata vëren se nuk rezulton që gjykatat e zakonshme të kenë dhënë një vendim që bie ndesh me parashikimet ligjore të KPP-së, si dhe nuk evidentohet që interpretimi i bërë nga ato të jetë zgjeruar në atë masë sa të cenojë garancitë procedurale të vendosura nga KPP-ja, duke rënduar në rastin konkret pozitën e kërkuesit. Gjithashtu, vendimet e cituara, të ngjashme në dukje, nuk janë vendime unifikuese ose njësuese të detyrueshme për zbatim, ndaj ato janë të pamjaftueshme për të krijuar pritshmëri të ligjshme nga ana e kërkuesit.

39. Në dritën e këtyre konsideratave, Gjykata vlerëson se në çështjen penale ndaj kërkuesit duket se ka informacione që do të bindnin një vëzhgues të paanshëm se ai mund të ketë kryer veprat penale për të cilat është i dyshuar, ndaj nuk mund të konkludohet se ai është arrestuar në mungesë të dyshimit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 27, paragrafi 2, shkronja "c", të Kushtetutës dhe nenit 5, pika 1, shkronja "c", të KEDNJ-së. Ndërkohë që gjykata e apelit nuk rezulton se ka zgjeruar faktin penal të paraqitur nga prokuroria, por ka analizuar në mënyrë konkrete rëndësinë e tij, duke i dhënë faktit penal një cilësim të drejtë. Për rrjedhojë, pretendimet e kërkuesit për cenimin e lirisë personale me argumentin e mungesës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, si dhe ai në drejtim të sigurisë juridike janë të pabazuara.

B.1.2. Në lidhje me parimin e proporcionalitetit

40. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të proporcionalitetit, duke parashtruar dy argumente kryesore, atë të vendosjes së një mase joproporcionale ndaj tij, si dhe mospranimin e zëvendësimit të masës së sigurimit të vendosur ndaj tij "Arresti në burg" me "Garancia pasurore". Sipas tij, vendimmarrja e gjykatave të zakonshme nuk ka pasqyruar në mënyrë të plotë shkaqet që i kanë orientuar ato në marrjen e vendimit dhe arsyet se përse caktimi i masës më të rëndë të sigurimit personal është vlerësuar i nevojshëm. Sipas tij, mospërcaktimi nga ana e tyre i rrezikshmërisë së kërkuesit, duke u fokusuar vetëm te rrezikshmëria e veprave penale, si dhe shtimi në mënyrë të paligjshme nga GJKKO-ja e Apelit e një vepre penale kanë ndikuar direkt në masën e sigurimit të kërkuesit, duke e bërë atë jo të ligjshme, jo të përshtatshme dhe joproporcionale. Po ashtu sipas kërkuesit, Gjykata e Lartë dhe ajo e shkallës së parë vlerësojnë se ka tre rreziqe ose ndryshe nevoja sigurimi, ndërkohë që gjyqtari i apelit, megjithëse konkludon për

një rrezik, vetëm atë të largimit, sërish e shikon masën e sigurimit personal "Arresti në burg" si proporcionale, njësoj me shkallën e parë.

41. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se GJKKO-ja e Apelit nuk ka aplikuar në arsyetimin e saj "kriteret e veçanta" të përcaktuara në nenin 230, pika 1, të KPP-së. Në këtë kuadër të dyja kriteret e përdorura nga gjyqtari i GJKKO-së së Apelit, respektivisht rrezikshmëria e veprave penale dhe numri i tyre, nuk përkojnë me ato të përcaktuara në pikën 1 të nenit 230 të KPP-së, e ndaj konsiderohen ekstraligjore. Sipas tij, të dyja gjykatat e faktit nuk kanë arsyetuar as për rrezikshmërinë e kërkuesit, as pse ai rrezikonte të largohej, duke i bërë këto vendime arbitrare dhe jo ligjore. Ato gjykata nuk kanë mbajtur parasysh faktin se kërkuesi hetohej edhe për një çështje tjetër nën masën e sigurimit "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore", masë të cilën nuk e kishte ankimuar, përkundrazi kishte treguar disponibilitet të plotë përkundrejt hetimeve. Gjithashtu, si gjykatat e faktit, ashtu edhe Kolegji Penal nuk kanë arsyetuar për kërkesën për zëvendësimin e masës së sigurimit "Arresti në burg" me "Garancinë pasurore", dhe një masë më të lehtë sigurimi.

42. Subjekti i interesuar për pretendimin që lidhet me proporcionalitetin e masës ka prapësuar se ai nuk qëndron, pasi sikurse me të drejtë kanë arsyetuar edhe gjykatat e zakonshme, kjo masë është në raport të drejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal dhe në përshtatje me nevojat e sigurimit dhe rëndësinë e faktit penal për të cilin kërkuesi dyshohet, si dhe sanksionet që ligji parashikon për ato vepra. Gjithashtu sipas subjektit të interesuar, gjykatat kanë arsyetuar në mënyrë shteruese lidhur me rrezikshmërinë e veprave për të cilat procedohet, detyrës që kërkuesi mbante dhe përsëritjes së tyre, të cilat tregojnë për një veprimtari të shtrirë në kohë dhe një mënyrë perceptimi të ushtrimit të detyrës që bie ndesh me ligjin dhe në favor të interesave pasurorë personalë. Për këto arsye, masa më e lehtë e sigurimit e kërkuar nga ai, "Garancia pasurore", ka qenë e papërshtatshme dhe joproporcionale.

43. Subjekti i interesuar ka prapësuar se nuk ka pasur shkelje të neneve respektive që garantojnë mbrojtjen konventore dhe kushtetuese, pasi vendimet e GJKKO-së së Apelit dhe të Kolegjit Penal i kanë dhënë përgjigje shteruese kërkuesit lidhur me domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e masës së sigurimit.

44. Gjykata ka pohuar se çdo masë që kufizon liritë dhe të drejtat e individit duhet të jetë në përputhje me ligjin, të ndjekë një qëllim legjitim dhe të respektojë një ekuilibër të drejtë midis interesit publik dhe të drejtat e liritë e tij. Një ndërhyrje do të konsiderohet "e nevojshme në një shoqëri demokratike" dhe për një qëllim të ligjshëm, nëse i përgjigjet një "nevoje sociale urgjente" dhe, në veçanti, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur, si dhe nëse arsyet e gjykatave për ta justifikuar atë janë "relevante dhe të mjaftueshme". Testi i proporcionalitetit të ndërhyrjes kërkon që masa të jetë e përshtatshme për të arritur funksionin mbrojtës. Me fjalë të tjera, një kufizim është i justifikueshëm vetëm për aq sa ai ndihmon në arritjen e qëllimit legjitim të synuar. Në vijim, në drejtim të kriterit të proporcionalitetit të ndërhyrjes, Gjykata analizon aspektet e nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë në raport me parashikimet e neneve 228, 229 e vijuese të KPP-së. Në bazë të parimit të subsidiaritetit, Gjykata rithekson se u takon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm që, përveç zbatimit të ligjit material dhe procedural penal, të mbajnë parasysh edhe jurisprudencën e Gjykatës dhe të GJEDNJ-së në lidhje me parimin e proporcionalitetit dhe se ajo duhet të konsiderohet si mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave *(shih vendimet nr. 1, datë 17.1.2025; nr. 81, datë 21.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese)*.

45. Sipas nenit 28, pika 3, fjalia e dytë, të Kushtetutës, i paraburgosuri ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të procedohet i lirë përkundrejt një garancie pasurore sipas ligjit. Këto garanci gjenden edhe në paragrafin 3 të nenit 5 të KEDNJ-së, sipas të cilit çdo person i arrestuar ose i paraburgosur në rrethanat e parashikuara në paragrafin 1, shkronja "c", të këtij neni duhet të dërgohet menjëherë përpara një gjyqtari ose një zyrtari tjetër të autorizuar me ligj për të

ushtruar funksione gjyqësore dhe ka të drejtë të gjykohet brenda një afati të arsyeshëm ose të lirohet në pritje të gjykimit, lirim që mund të kushtëzohet me dhënien e garancive për t'u paraqitur në procesin gjyqësor.

46. Gjykata, bazuar në jurisprudencën e saj për nenin 28, pika 3, të Kushtetutës, ka theksuar se kjo dispozitë rregullon kohëzgjatjen e paraburgimit dhe mbron situatën kur paraburgimi nuk justifikohet më me arsye të interesit publik, ndaj këto garanci nuk u japin autoriteteve gjyqësore një zgjedhje midis dërgimit të personit të akuzuar në gjyq brenda një kohe të arsyeshme ose lirimit të përkohshëm në pritje të gjykimit. Qëllimi i tyre është, në thelb, që i paraburgosuri të kërkojë lirimin e përkohshëm atëherë kur vijimi i paraburgimit pushon së qeni i arsyeshëm dhe nuk u përgjigjet më nevojave të sigurimit. Çështja nëse një periudhë kohore e kaluar në paraburgim është e arsyeshme nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte, por në bazë të fakteve të secilit rast dhe veçorive të tij specifike. Vazhdimi i paraburgimit mund të justifikohet vetëm nëse ka tregues specifikë të një kërkese të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë individuale të përcaktuar në nenin 5 të KEDNJ-së. Në thelb, Gjykata ka pohuar se vijimi i ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova është një kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e vazhdimit të paraburgimit. Ka një dallim të dukshëm midis situatës kur autoritetet gjyqësore shqyrtojnë për herë të parë, "menjëherë" pas arrestimit, nëse personi i dyshuar do të qëndrojë në paraburgim, me situatën kur pas një kohe të caktuar nevojitet vijimi i masës së arrestit. Në rastin e fundit dyshimi i arsyeshëm i bazuar në prova duhet të jetë i tillë që autoritetet të japin njëkohësisht arsye të qarta, relevante dhe të mjaftueshme për të justifikuar vijimin e paraburgimi, konform rrethanave individuale të secilit rast penal. Iu takon prokurorisë dhe gjykatave të zakonshme të përcaktojnë qëndrueshmërinë e shkaqeve që justifikojnë vazhdimin e paraburgimit dhe barra e provës nuk duhet të kthehet duke i kërkuar personit të ndaluar që të provojë ekzistencën e arsyeve që garantojnë lirimin e tij. Mbi këtë bazë, në vijim, Gjykata është shprehur se në kuptim të nenit 28, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 5, paragrafi 3, të KEDNJ-së, i paraburgosuri ka të drejtë që të kërkojë procedimin e tij në liri dhe gjykatat janë të detyruara të marrin në konsideratë nëse ka ende arsye që justifikojnë masën kufizuese të lirisë dhe nëse nevojat e sigurimit mund të garantohen me garanci të tjera ose masa alternative, duke vlerësuar në çdo rast proporcionalitetin e masës së caktuar në drejtim të përshtatshmërisë së saj *(shih vendimin nr. 86, datë 20.12.2024, të Gjykatës Kushtetuese)*.

47. Ndërkohë, KPP-ja, në nenin 228, pika 3, përcakton kushtet e veçanta, alternative, për vendosjen e masave të sigurimit personal dhe konkretisht: kur ekzistojnë shkaqe të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, bazuar në rrethana fakti që duhet të tregohen posaçërisht në arsyetimin e vendimit (shkronja "a"); kur i pandehuri është larguar ose ekziston rreziku që ai të largohet (shkronja "b"); kur për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit të të pandehurit ka rrezik që ai të kryejë krime të rënda ose të të njëjtit lloj me atë për të cilin procedohet (shkronja "c"). Neni 229 përcakton kriteret e përgjithshme për caktimin e masave të sigurimit personal, duke parashikuar se gjykata mban parasysh përshtatshmërinë e secilës masë me shkallën e nevojave të sigurimit që duhen marrë në rastin konkret (pika 1) dhe ato duhet të jenë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikohet për veprën penale konkrete. Në këtë rast mbahen parasysh vazhdimësia, përsëritja, si dhe rrethanat lehtësuese e rënduese të parashikuara nga KP-ja (pika 2). Kurse neni 230 përcakton kriteret e veçanta për caktimin e masës së arrestit në burg, duke parashikuar, ndër të tjera, se një masë e tillë mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit (pika 1).

48. Për sa më lart, si dhe referuar thelbit të argumenteve të parashtruara në ankimin kushtetues individual, Gjykata vlerëson të analizojë nëse gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, në caktimin e masës së sigurimit, kanë arsyetuar mjaftueshëm për ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme që

vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës për rrezikun që i pandehuri të largohet, si dhe për rrezikun që për shkak të rrethanave të faktit dhe personalitetit kërkuesi të kryejë krime të tjera. Për këtë qëllim, Gjykata do të mbajë në konsideratë kontekstin e fakteve të çështjes për të përcaktuar nëse masa e caktuar ndaj kërkuesit është në përpjesëtim me shkakun ligjor për të cilin është vendosur, si dhe nëse çdo masë tjetër është e papërshtatshme.

49. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, pa rënë në përsëritje të fakteve në lidhje me proceset gjyqësore që çuan në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit dhe vazhdimin e paraburgimit të tij, sikurse më lart ato u parashtruan, Gjykata çmon të evidentojë në vijim arsyet e veçanta që gjykatat e zakonshme parashtruan për justifikimin e paraburgimit të kërkuesit përtej atij të ekzistencës së dyshimit të arsyeshëm të bazuar në prova, si dhe për sa u përket argumenteve të tyre rreth përshtatshmërisë së kësaj mase.

50. Gjykata konstaton se GJKKO-ja e Shkallës së Parë, pasi ka argumentuar se plotësohen të dyja kushtet e përgjithshme të përcaktuara në nenin 228 të KPP-së, ka marrë në analizë kushtet e veçanta të përcaktuara në pikën 3 të të njëjtit nen, në përputhje edhe me qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues nr. 7, datë 14.10.2011. Konkretisht, ajo gjykatë ka marrë, së pari, në shqyrtim ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provave, së dyti, rrezikun e largimit dhe, së fundmi, rrezikun që personi nën hetim të kryejë krime më të rënda ose të njëjta me atë për të cilin procedohet.

51. Lidhur me ekzistencën e shkaqeve të rëndësishme që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provave, ajo gjykatë ka arsyetuar se në kushtet kur nuk kishte përfunduar marrja e provave nga ana e organit të akuzës, ekzistonte mundësia që të pandehurit, përfshirë kërkuesin, për shkak të rolit të tij, të ndikonin negativisht në këtë proces, veçanërisht në raport me subjektet që kanë përfituar shumat monetare. Ky konkluzion i asaj gjykate vjen si pasojë edhe e intensitetit të hetimeve pas caktimit të masës, si dhe e hetimit të raporteve mes kërkuesit dhe subjekteve përfituese të shumave monetare. Për sa i takon rrezikut të largimit, ajo gjykatë ka arsyetuar se në rastin e kërkuesit ky rrezik rezulton prezent në raport me veprat penale për të cilat procedohet, rrezikshmërinë e tyre, si dhe marzhet e dënimit për këto vepra, ndërkohë që nuk ka të dhëna që të dëshmojnë rrezikshmëri lidhur me personalitetin dhe sjelljen e tij. Duke marrë në analizë elementin e tretë që lidhet me rrezikun që personi nën hetim të kryejë krime më të rënda ose të njëjta me atë për të cilin procedohet, ajo gjykatë ka argumentuar se pavarësisht rrethanave rënduese si bashkëpunimi, kryerja disa herë e së njëjtës vepër dhe mekanizmit të kryerjes së veprës penale, në kushtet kur kërkuesi nuk kryen më detyrën publike, ky rrezik nuk paraqitet në nivele tepër të larta.

52. Po ashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë, lidhur me përshtatshmërinë e masës, në vijim ka arsyetuar se në caktimin e masës së sigurimit "Arresti në burg" për kërkuesin përmbushen kriteret e përcaktuara në nenet 229 dhe 230 të KPP-së. Konkretisht, referuar pikës 1 të nenit 229 të KPP-së, shkalla e nevojave të sigurimit rezulton e lartë referuar rrezikshmërisë së veprave për të cilat dyshohet, kryerjes së disa prej veprave disa herë, të shtrira në kohë dhe në prezencë të rrethanave rënduese, në abuzim me funksionin publik, duke dëshmuar prezencën e një mendimi të konsoliduar kriminal dhe raportin e dobët të kërkuesit në respektimin e ligjit. Ajo gjykatë në caktimin e masës ka mbajtur parasysh edhe masën e dënimit për veprat penale për të cilat kërkuesi dyshohet, kryerjen më shumë se një herë të veprave penale, si dhe prezencën e kushteve të veçanta alternative, të parashikuara nga neni 288, pika 3, i KPP-së. Në përfundim, ajo gjykatë ka konkluduar se nga analiza e kryer rezulton se masa e caktuar "Arresti në burg" është e përshtatshme dhe se nuk rezulton të jetë prezent asnjë nga rrethanat të cilat nuk lejojnë caktimin e kësaj lloj mase.

53. Në vijim, Gjykata konstaton se në vendimin për vazhdimin e zbatimit të masës "Arresti në burg" ndaj kërkuesit, gjykata e shkallës së parë, pasi ka dëgjuar pretendimet e kërkuesit, ka arritur në përfundimin se nuk rezulton asnjë rrethanë e ndryshme në lidhje me arsyet e veçanta për

justifikimin e paraburgimit në kuptim të nenit 228, pika 3, të KPP-së, duke konfirmuar me të njëjtat argumente qëndrimin e mbajtur në rastin e caktimit të masës.

54. GJKKO-ja e Apelit ka analizuar në vijim masën e sigurimit që duhej të caktohej në raport me rrethanat e çështjes. Për sa u takon nevojave të sigurimit, në analizë të kushteve të veçanta të parashikuara nga neni 228, pika 3, i KPP-së, ajo gjykatë, ndryshe nga gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se për kërkuesin ekziston vetëm rreziku i largimit i lidhur me veprat penale të cilat i atribuohen atij, rrezikshmërinë që ato paraqesin dhe masën e sanksionit që ato parashikojnë. Po ashtu, GJKKO-ja e Apelit e ka konsideruar të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë lidhur me përshtatshmërinë e masës dhe në përfundim të analizës së saj e ka konsideruar masën proporcionale. Ajo gjykatë lidhur me kërkesën për zëvendësim të masës ka arsyetuar se arsyet e mosndryshimit të masës lidhen me rrezikshmërinë e kërkuesit vetëm në raport me faktin penal objekt procedimi, mënyrën e kryerjes dhe rëndësinë e tij.

55. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në vendimin e tij për lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, ka konfirmuar kushtet e veçanta për caktimin e masës së sigurimit personal, duke konkluduar për këtë pjesë ndryshe nga gjykata e apelit, e cila vlerëson se ekziston vetëm rreziku i ikjes për kërkuesin, se ekzistojnë të tria këto kushte, pra përveç rrezikut të ikjes edhe rreziku për helmimin e provave, si dhe, megjithëse në masë të vogël, ai për të kryer vepra të tjera penale. Gjithashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka konfirmuar se përmbushet edhe përshtatshmëria, si dhe proporcionaliteti i masës në raport me rrethanat e faktit, rolin dhe pozitën e personit nën hetim, si dhe në raport me nevojat e sigurimit. Në përfundim, Kolegji Penal ka konkluduar se në rastin konkret kërkuesi nuk ka provuar nevojën e caktimit të një mase sigurimi personal më të butë nga ajo në fuqi.

56. Nga sa më lart, Gjykata vëren se në vendimet e tyre gjykatat e zakonshme nuk e kanë justifikuar vazhdimin e paraburgimit të kërkuesit vetëm mbi ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se ai ka kryer veprat penale, por kanë dhënë edhe arsye të tjera të veçanta, të tilla si rreziku i marrjes dhe manipulimit të provave, rreziku i largimit, rreziku i arratisjes së kërkuesit, si dhe, megjithëse i vogël, rreziku që kërkuesi të kryente vepra të tjera penale, arsye këto të përshtatshme dhe të mjaftueshme në aspektin kushtetues dhe konventor për justifikimin e vazhdimit të paraburgimit të një individi. Arsyetimi i tyre në këtë drejtim nuk është abstrakt. Duket se gjykatat e zakonshme kanë shpjeguar në mënyrë konkrete dhe të mjaftueshme praninë në këtë rast të atyre rreziqeve, duke evidentuar kompleksitetin e hetimit, në pikëpamje të shtrirjes në kohë të veprimtarisë së dyshuar si kriminale, bashkëpunimin, rolin e tij në kryerjen e veprave penale, por edhe ndikimin potencial negativ që ai mund të kishte në vijimin e hetimeve.

57. Edhe për sa i takon pretendimit për mosarsyetimin e kërkesës së tij për zbutjen e masës së sigurisë nga "Arresti në burg" me atë "Garancia pasurore" dhe një masë më të lehtë, GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe Gjykata e Lartë, duke argumentuar nevojat e masës aktuale të sigurimit, i kanë dhënë përgjigje edhe këtij pretendimi, ndërsa GJKKO-ja e Apelit i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimit, çka e bën të mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese. Gjithashtu, në shtesë të argumenteve të mësipërme, Gjykata vlerëson se garancia pasurore sipas nenit 28, pika 3, të Kushtetutës lidhet me kohëzgjatjen e masës, në rast të kontrollit vijues të vendimeve për caktimin e saj. Ndërkohë që, Gjykata, duke mbajtur në konsideratë objektin e ankimit kushtetues, që ka të bëjë me caktimin e masës së sigurimit, parimin e subsidiaritetit dhe mjetet juridike që kërkuesi ka në dispozicion, i referohet momentit faktik kur ajo masë është vlerësuar nga gjykatat e zakonshme dhe jo kohës së kaluar nga caktimi i masës deri në momentin e shqyrtimit kushtetues. Thënë ndryshe, kjo dispozitë rregullon kohëzgjatjen e paraburgimit dhe kërkon që masa e heqjes së lirisë të ketë humbur qëllimin e saj, pra të mos justifikohet më me arsye të interesit publik. Në këtë mënyrë, Gjykata çmon se paraqitja e kërkesës për t'u proceduar i lirë kundrejt garancisë pasurore

kërkon kalimin e një periudhe kohe, pas së cilës gjykata mund të verifikojë nëse ekzistojnë ende kushtet dhe nevojat e sigurimit.

58. Gjithashtu, Gjykata evidenton se kërkuesi, siç ka pohuar edhe vetë, kishte edhe një masë të mëparshme sigurimi personal "Detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore" në kohën kur kanë dalë fakte të reja penale që kanë bërë të iniciohet një procedim tjetër penal, për disa vepra të reja penale. Në këtë drejtim, GJKKO-ja e Shkallës së Parë dhe GJKKO-ja e Apelit kanë evidentuar në vendimet e tyre ekzistencën e fakteve që mbështesin dyshimin e arsyeshëm se kërkuesi mund të ketë kryer veprat e reja penale për të cilat dyshohet, duke detajuar në arsyetimin e tyre rrethanat që kanë vlerësuar për efekt të caktimit të masës më të rëndë të sigurimit me karakter shtrëngues. Gjithashtu, GJKKO-ja e Shkallës së Parë iu referua nevojës për të përfunduar hetimin si shkak për caktimin dhe vijimin e masës së sigurimit ndaj kërkuesit, duke specifikuar provat që duhej të mblidheshin ende, të cilat konsistonin në vërtetimin e lidhjeve mes kërkuesit dhe subjekteve përfituese të shumave monetare. Vendimet e gjykatave të faktit janë lënë në fuqi nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili i ka konsideruar të drejta argumentet e dhëna nga ato gjykata, si dhe ka arsyetuar gjetjet në drejtim të të drejtave procedurale e kushtetuese të kërkuesit. Të tria gjykatat e zakonshme kanë analizuar edhe në drejtim të kushteve të veçanta të parashikuara nga neni 228, pika 3, i KPP-së.

59. Për sa i përket rrezikut të largimit për t'iu shmangur procedimit penal, pra rrezikut të arratisjes së kërkuesit, Gjykata vëren se gjykatat e zakonshme në mënyrë të arsyeshme i janë referuar natyrës së veprave penale për të cilat ai dyshohej, rëndësisë së faktit, sanksionit për veprat penale, natyrës dhe shkallës së pasojave të ardhura prej tyre, çka në raport edhe me sjelljen e shfaqur nga ai në vijimësi si dhe në raport me përmbushjen e detyrimeve ligjore në ushtrimin e funksioneve ose shërbimeve me karakter publik, pra prirjen e tij për të mos iu bindur ligjit, tregojnë për mundësinë e largimit të tij nëse do të ishte i lirë. Nga ana tjetër, pretendimi i tij se ka pasur një procedim tjetër penal gjatë të cilit ai ishte treguar bashkëpunues me autoritetet, jo domosdoshmërisht tregon për mungesën e rrezikut të arratisjes në rastin konkret, për më tepër që një fakt i tillë, pra ekzistenca e procedimeve të tjera penale, mund të jetë tregues më së paku jo pozitiv në drejtim të personalitetit të tij. Gjykata thekson se për vlerësimin e të tilla rrethanave gjykatat e zakonshme janë në pozicionin e duhur të bëjnë vlerësimin e fakteve, për shkak se ndjekin në vazhdimësi ecurinë e procedimit penal. Gjykata vlerëson nga pikëpamja kushtetuese arsyetimin e vendimeve gjyqësore, për të siguruar respektimin e standardeve kushtetuese, porse nuk hyn në vlerësimin e fakteve duke zëvendësuar rolin e gjykatave të zakonshme.

60. Gjykata vëren, në vijim, se gjykatat e zakonshme kanë parashtruar mjaftueshëm argumente edhe në drejtim të përshtatshmërisë së masës së paraburgimit të kërkuesit dhe përfundimi i tyre se çdo masë tjetër nuk është e përshtatshme nuk duket e paarsyeshme në raport me nevojat e sigurimit që janë evidentuar në rastin konkret.

61. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se urdhërimi i gjykatave të zakonshme për vazhdimin e paraburgimit të kërkuesit duket se është i justifikuar mbi tregues specifikë të një kërkese të vërtetë të interesit publik, e cila, pavarësisht nga prezumimi i pafajësisë së tij, tejkalon rregullin e respektimit të lirisë personale të përcaktuar në nenin 27 të Kushtetutës dhe nenin 5 të KEDNJ-së.

Në këtë kontekst, për qëllime të vlerësimit të parimit të proporcionalitetit në caktimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuesit, Gjykata çmon se masa e sigurimit personal "Arresti në burg" nuk është në raport të zhdrejtë me qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal dhe rezulton në përshtatje me nevojat e sigurimit dhe rëndësinë e faktit penal për të cilin ai dyshohet, si dhe sanksionin që parashikohet nga ligji për ato vepra penale. Ky përfundim bazohet në arsyetimin e vendimeve të gjykatave të zakonshme, të cilat i kanë dhënë përgjigje shteruese kërkuesit lidhur me nevojën, domosdoshmërinë dhe ashpërsinë e masës së sigurimit personal

“Arresti në burg” në kontekstin e rrethanave të çështjes konkrete dhe sipas rregullave specifike të KPP-së.

62. Në këtë këndvështrim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesit për kufizimin e lirisë personale, për shkak të caktimit të zbatimit të masës së sigurimit personal “Arresti në burg”, janë të pabazuara, për sa kohë që masa është vendosur për një qëllim të ligjshëm, garantimin e mbarëvajtjes së procesit penal në ngarkim të tij, dhe ajo nuk duket të jetë joproporcionale në kontekstin e rrethanave të çështjes dhe në raport me veprat penale për të cilat ai dyshohet, si dhe është në përputhje me rregullat procedurale të KPP-së për caktimin e saj.

63. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale është i pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të vendimit, ndaj kërkesa rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 28.1.2026.
Shpallur më 13.3.2026.

Kryetare: Fiona Papajorgji
Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Marjana Semini, Ilir Toska, Asim Vokshi
Anëtarë kundër: Sonila Bejtja, Sandër Beci

MENDIM PAKICE

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuesit Ilir Beqaj, me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore me të cilat është caktuar masa e sigurimit të arrestit në burg ndaj tij, jemi kundër vendimit të shumicës për rrëzimin e kërkesës, pasi vlerësojmë që ajo duhej të ishte pranuar, për shkak se pretendimet e tij për cenim të parimit të lirisë personale dhe parimit të proporcionalitetit të lidhura me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor janë të bazuara. Në mbështetje të neneve 132, pika 3, të Kushtetutës dhe 72, pika 8, të Ligjit Organik të Gjykatës, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Kërkuesi nga viti 2021 ka qenë i ngarkuar me detyrën e drejtorit të SASPAC-ut. Në ushtrim të këtij funksioni kërkuesi ka pasur si detyrë të kryente detyrën e Koordinatorit Kombëtar për Instrumentin e Paraaderimit të Asistencës Financiare të Bashkimit Evropian lidhur me ndihmën e huaj për programe dhe projekte zhvillimore. Ai dyshohet se, në kundërshtim me ligjin, nuk ka deklaruar pasuri, të cilat, nga hetimet e Prokurorisë së Posaçme, rezultojnë në pronësinë e tij. Gjithashtu, kërkuesi dyshohet se në bashkëpunim ka siguruar produkte nga një shoqëri, ku ortake është bashkëshortja e tij, duke i fshehur nëpërmjet pagesave, sikur janë bërë nga një tjetër kompani.

Edhe eventet e organizuara në restorantin "G.", ku dyshohet se ka interesa pasurorë kërkuesi, paguheshin nëpërmjet faturave të lëshuara nga subjekte të tjera për të mosekspozuar këtë aktivitet dhe lidhjen me të. Për këto fakte, ai dyshohet se në cilësinë e drejtorit të SASPAC-ut ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe detyrën e tij, duke realizuar përfitime të paligjshme. Prokuroria e Posaçme ka regjistruar emrat e autorëve të dyshuar, ndër të tjerë, edhe emrin e kërkuesit në datën 18.6.2024, ndërsa ky i fundit është i dyshuar si autor i veprave penale të parashikuara nga nenet 143, paragrafët 2 dhe 3, 260 e 25, 257/a, paragrafi 2, si edhe 258, paragrafi 2, e 25 të KP-së.

3. Mbi këto fakte, kërkuesi ka pretenduar në thelb se masa e sigurimit të arrestit në burg nuk është proporcionale dhe se gjykatat kanë zhvilluar një proces të parregullt ligjor, me anë të të cilit i kanë cenuar atij lirinë personale. Pretendimet e tij janë prapësuar si të pabazuara nga subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme, me argumentet se kufizimi i lirisë së kërkuesit është bërë në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Kushtetutës dhe se masa e sigurimit personal "Arresti në burg" e vendosur ndaj tij është proporcionale.

4. Sipas nenit 27 të Kushtetutës askujt nuk mund t'i hiqet liria, përveçse në rastet dhe sipas procedurave të parashikuara me ligj *(pika 1)* dhe se liria e personit nuk mund të kufizohet, përveçse në rastin kur ka dyshime të arsyeshme se ka kryer një vepër penale ose për të parandaluar kryerjen prej tij të veprës penale ose largimin e tij pas kryerjes së saj *(pika 2, shkronja "c")*. Gjykata ka theksuar se qëllimi kryesor i kësaj dispozite është të parandalojë heqjen arbitrare ose të pajustifikuar të lirisë, pasi e drejta për lirinë personale është e një rëndësie jetike për një shoqëri demokratike. Në rastet që kanë të bëjnë me heqjen e lirisë është thelbësore që kushtet për heqjen e lirisë të jenë qartësisht të përcaktuara në ligj dhe ky i fundit duhet të jetë mjaftueshëm i qartë për t'i mundësuar individit që të parashikojë, në një shkallë të arsyeshme, rrethanat dhe pasojat që mund të sjellë një veprim i caktuar *(shih vendimet nr. 24, datë 27.4.2023; nr. 39, datë 15.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese)*.

5. Në ndryshim nga shumica, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se në rastet kur gjykimi kushtetues ka në objektin e tij kontrollin e lirisë personale, si pasojë e caktimit të një mase sigurie shtrënguese, Gjykata duhet të përdorë kritere të ndryshme nga ato të gjykimeve të themelit për vlerësimin sesi garancitë kushtetuese janë zbatuar në praktikë. Këto kritere vlerësimi nuk mund të jenë të njëjta me ato që përdoren në kontrollin kushtetues të vendimeve të tjera gjyqësore. Gjykata kishte detyrimin që çështjen ta vlerësonte bazuar në kritere të tilla që të merrnin parasysh në mënyrë transparente jo vetëm rrethanat relevante të procedimit penal të kërkuesit, por, mbi të gjitha, edhe rrethanat lehtësuese, funksionet që ai kishte mbajtur më parë, personalitetin e tij, gatishmërinë për të respektuar masën e vendosur në një procedim tjetër, etj.

6. Lidhur me rëndësinë e lirisë personale dhe kufizimin e saj si pasojë e masës ekstreme "Arresti në burg", edhe vetë shumica ka pohuar se kushtet, kriteret dhe procedurat për caktimin, zbatimin, rivlerësimin, zëvendësimin dhe kontrollin gjyqësor për masat e sigurimit, veçanërisht atyre të arrestit, janë drejtpërdrejt të lidhura me lirinë e personit. Megjithatë, një pohim i tillë mbetet teorik, në mendimin tonë, nëse nuk vihet theksi se pikërisht për këtë shkak Gjykata kur kontrollon masën e arrestit në burg përdor kritere më rigoroze vlerësimi të cenimit të parimeve dhe standardeve kushtetuese. Thënë ndryshe, kur objekti i gjykimit kushtetues lidhet me garancitë kushtetuese procedurale (siç është edhe parimi kushtetues i sanksionuar nga neni 17 i Kushtetutës, pra parimi i proporcionalitetit në drejtim të ashpërsisë, domosdoshmërisë e nevojshmërisë së masës), kriteret janë të ndryshme në raport me ato që përdoren gjatë kontrollit të vendimeve gjyqësore të tjera që japin gjykatat për zgjidhjen e çështjeve të paraqitura pranë tyre. Kjo e merr arsyen nga fakti se "Arresti në burg" heq lirinë personale të individit, i cili ende nuk është deklaruar fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë, kjo lloj mase sigurimi, në dukje, krijon përplasje me parimin e prezumimit të pafajësisë së individit, ndaj do të duhet të konsiderohet një *extrema ratio* me natyrë përjashtimore, që caktohet vetëm kur përmbushen të gjitha kriteret rigorozisht të

përcaktuara nga ligji, që imponon njëherazi edhe detyrën ndaj gjykatave për arsyetim rigoroz kur japin vendim për caktimin e saj.

7. Shumica ka dalë me përfundimin se nuk ka shkelje të lirisë personale në të dyja aspektet e masës së sigurisë personale, atë të dyshimit të arsyeshëm dhe atë të proporcionalitetit të masës. Në kuadër të aspektit të dyshimit të arsyeshëm, shumica është ndalur në analizimin e faktit që GJKKO-ja e Apelit ka konsideruar se veprimet e kërkuesit mund të kualifikohen nën veprën penale "Falsifikimi i dokumenteve", të parashikuar nga neni 186, paragrafi 3, i KP-së. Në këtë kontekst shumica ka çmuar se shtimi dhe ndryshimi i akuzës janë veprime procedurale formale, të cilat kryhen nga organi procedues (prokurori ose gjykata), pasi individi merr cilësinë e të pandehurit me aktin e njoftimit të akuzës nga prokurori, në të cilin, në përputhje me nenin 34 të KPP-së, tregohen të dhënat e mjaftueshme. Në këtë kuptim, dhe për sa kohë gjykata e apelit nuk ka zgjeruar faktin penal të paraqitur nga prokuroria në kërkesën për caktimin e masës së sigurimit, është e qartë që vlerësimi i saj për ekzistencën e elementeve të veprës penale të falsifikimit të dokumenteve mbi faktin e paraqitur nga prokurori nuk përbën ngritje të një akuze të re nga gjykata. Në thelb, ai përbën vlerësim të gjykatës të nevojave të sigurimit, që kërkon, ndër të tjera, të analizohet në mënyrë konkrete rëndësia e faktit penal. Duke u bazuar tek arsyetimi i gjykatave të zakonshme, shumica ka çmuar se sjellja e dyshuar e kërkuesit, në mënyrë të arsyeshme, mund të përfshihej nën veprat penale për të cilat dyshohej, nëse do të vërtetohej kryerja e tyre *(shih paragrafët 33 dhe 34 të vendimit)*.

8. Ndërsa në lidhje me aspektin e dytë, parimin e proporcionalitetit në caktimin e masës së sigurimit ndaj kërkuesit, shumica ka pohuar se gjykatat e zakonshme nuk e kanë justifikuar vazhdimin e paraburgimit të kërkuesit vetëm mbi ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se ai ka kryer veprat penale, por kanë dhënë edhe arsye të tjera të veçanta, të tilla, si rreziku i marrjes dhe manipulimit të provave, rreziku i largimit, arratisjes së kërkuesit, si dhe, megjithëse i vogël, rreziku që kërkuesi të kryente vepra të tjera penale, arsye këto të përshtatshme dhe të mjaftueshme në aspektin kushtetues dhe konventor për justifikimin e vazhdimit të paraburgimit të një individi. Arsyetimi i tyre në këtë drejtim nuk është abstrakt, arsyeton shumica, ndërkohë që duket se gjykatat e zakonshme kanë shpjeguar në mënyrë konkrete dhe të mjaftueshme praninë në këtë rast të atyre rreziqeve, duke evidentuar kompleksitetin e hetimit, në pikëpamje të shtrirjes në kohë të veprimtarisë së dyshuar si kriminale, bashkëpunimin, rolin e tij në kryerjen e veprave penale, por edhe ndikimin potencial negativ që ai mund të kishte në vijimin e hetimeve *(shih paragrafin 56 të vendimit)*.

9. Për sa i takon pretendimit për mosarsyetimin e kërkesës së tij për zbutjen e masës së sigurisë nga "Arresti në burg" me atë "Garancia pasurore" dhe një masë më të lehtë, shumica ka arsyetuar se duke mbajtur në konsideratë objektin e ankimit kushtetues, që ka të bëjë me caktimin e masës së sigurimit, parimin e subsidiaritetit dhe mjetet juridike që kërkuesi ka në dispozicion, ajo i referohet momentit faktik kur ajo masë është vlerësuar nga gjykatat e zakonshme dhe jo kohës së kaluar nga caktimi i masës deri në momentin e shqyrtimit kushtetues. Thënë ndryshe, kjo dispozitë rregullon kohëzgjatjen e paraburgimit dhe kërkon që masa e heqjes së lirisë të ketë humbur qëllimin e saj, pra të mos justifikohet më me arsye të interesit publik. Në këtë mënyrë, shumica çmon se paraqitja e kërkesës për t'u proceduar i lirë kundrejt garancisë pasurore kërkon kalimin e një periudhe kohe, pas së cilës gjykata mund të verifikojë nëse ekzistojnë ende kushtet dhe nevojat e sigurimit *(shih paragrafin 57 të vendimit)*.

10. Duke ndjekur këtë linjë arsyetimi dhe bazuar në nenet 17 dhe 27 të Kushtetutës, për të vlerësuar nëse ndërhyrja që kërkuesi ka pësuar në lirinë personale respekton kriteret kushtetuese dhe konventore të ndërhyrjes, duhet analizuar nëse ndërhyrja është bërë *vetëm me ligj*, për interes publik dhe nëse është në raport të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë (kriteri i proporcionalitetit).

11. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara nga kërkuesi janë nxjerrë bazuar në nenet 228 e vijuese të KPP-së, të cilat, në përputhje me nenin 27 të Kushtetutës, lejojnë që gjatë një procedimi penal të caktohet masa e sigurimit të arrestit në burg ndaj individit që dyshohet të ketë kryer një vepër penale. Për rrjedhojë, vlerësojmë se ndërhyrja në lirinë personale është bërë me ligj.

12. Për sa i takon interesit publik, ndajmë qëndrim të njëjtë me shumicën se caktimi i masës "Arresti në burg" ka ndjekur një qëllim legjitim dhe se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë analizuar mjaftueshëm ekzistencën e fakteve ose informacioneve që kanë çuar në dyshimin e arsyeshëm për kryerjen e veprave penale për të cilat kërkuesi akuzohet. Megjithatë, ne, gjyqtarët në pakicë, duke mbajtur parasysh edhe jurisprudencën e GJEDNJ-së në rastin Gëllçi kundër Shqipërisë, ku është theksuar se vazhdimësia e një dyshimi të arsyeshëm është kusht *sine qua non* për vlefshmërinë e arrestit në burg, por nuk mjafton më pasi kalon një farë kohe ndaj Gjykata duhet të verifikojë nëse shkaqe të tjera të dhëna nga autoritetet gjyqësore vazhdojnë të justifikojnë heqjen e lirisë dhe nëse këto shkaqe janë "relevante" dhe "të mjaftueshme", Gjykata, gjithashtu, duhet të sigurohet nëse autoritetet kompetente kombëtare kanë treguar "kujdesin e veçantë" në zhvillimin e procesit *(shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DHM], nr. 23755/07, §§ 84-91, 102, dhe Merabishvili kundër Gjeorgjisë ([DHM], nr. 72508/13, §§ 222-25, 28 nëntor 2017)*, vlerësojmë se masa e sigurimit ndaj kërkuesit nuk duhet të justifikohet vetëm mbi ekzistencën *per se* të dyshimit të arsyeshëm, të shkëputur nga rrethanat e tjera, se ai ka kryer veprat penale, por duhet analizuar së bashku me ato, duke dhënë edhe arsye të tilla, si rreziku i vërtetimit të kushteve të veçanta të përcaktuara në nenin 228, pika 3, të KPP-së. Në këtë kontekst, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se ajo që mbetet për t'u përcaktuar është nëse në caktimin e masës së sigurimit të arrestit në burg ndaj kërkuesit janë analizuar sa duhet rreziqet e përcaktuara nga neni 228 i KPP-së dhe nëse masa është proporcionale, pra nëse është në raport të drejtë me nevojën për të garantuar mbarëvajtjen dhe integritetin e procedimit penal që po zhvillohet ndaj tij, si dhe me rëndësinë e veprës penale për të cilën dyshohet. Me fjalë të tjera, duhet analizuar nëse masa e sigurimit e arrestit në burg, e cila është përdorur si mjet për të arritur qëllimin legjitim, ka qenë: (i) *e përshtatshme*, në kuptimin se sa e arsyeshme ka qenë kjo masë, duke analizuar interesat dhe të drejtat që konkurrojnë me njëra-tjetrën; dhe (ii) *e nevojshme*, në kuptimin nëse masa ka mundësinë të arrijë qëllimin legjitim, atë të sigurimit të mbarëvajtjes së procedimit penal.

13. Duke iu kthyer analizës së proporcionalitetit, GJEDNJ-ja për nenin 5 të KEDNJ-së ka theksuar se rreziku i largimit duhet të vlerësohet nën dritën e faktorëve të tillë që lidhen me personalitetin (e të akuzuarit/pandehurit), banesën, punën, pasuritë, lidhjet familjare dhe çdo lidhje tjetër me vendin ku zhvillohet procesi penal (shih Becciev kundër Moldavisë, datë 4.10.2005, §§ 58-59). Rreziku i kryerjes së veprave të tjera penale është një ndër shkaqet që mund të bindin autoritetet gjyqësore që të vendosin dhe lënë në paraburgim një të dyshuar. Megjithatë është e nevojshme që rreziku të jetë i besueshëm nën dritën e rrethanave të çështjes, historikut dhe personalitetit të të dyshuarit. Dënimet e mëparshme mund të shërbejnë si shkas për të besuar në mënyrë të arsyeshme se i akuzuari mund të kryejë vepra penale të tjera *(shih Selc'uk kundër Turqisë, datë 10.1.2006, § 34)*. Sipas GJEDNJ-së, këto rreziqe duhet të tregohen me argumente thelbësore dhe arsyetimi i autoriteteve për këto çështje nuk mund të jetë abstrakt, i përgjithshëm ose stereotip *(shih Merabishvili kundër Gjeorgjisë, [DhM], datë 28.11.2017, § 222)*. Në këtë kuptim, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se vendimi i saj nëse ka pasur ose jo cenim të nenit 5/3 të KEDNJ-së do të merret bazuar në arsyetimin e vendimeve të autoriteteve kombëtare (*shih Buzadji kundër Republikës së Moldavisë [DhM], datë 5.7.2016, §§ 89-91*).

14. Në këtë drejtim, shumica ka konstatuar se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar se "Arresti në burg" është masa e sigurimit më e përshtatshme, duke vënë theksin te rreziku i ikjes së kërkuesit dhe shmangies së tij nga hetimi penal dhe te ndikimi i tij në marrjen e provave, duke i lidhur këto me rëndësinë e veprave për të cilat akuzohet dhe marzhet e tyre të

dënimit (*shih paragrafët 50 deri 55 të vendimit*). Në lidhje me këto argumente të gjykatave të zakonshme, shumica ka konkluduar se ato përbëjnë arsye të mjaftueshme për justifikimin e kufizimit të lirisë së kërkuesit dhe se gjykatat e zakonshme kanë shfaqur kujdes të veçantë në realizimin e procesit ndaj tij, si dhe kanë arsyetuar mjaftueshëm në lidhje me "masën e duhur" të sigurimit personal dhe nevojën që ajo të arrinte qëllimin e kërkuar *(shih paragrafin 56 të vendimit)*.

15. Për sa i takon kriterit se sa *e nevojshme* ka qenë masa e sigurimit të arrestit në burg ndaj kërkuesit për të arritur mbarëvajtjen e procedimit penal, jemi të mendimit se arsyetimi i gjykatave të zakonshme në çështjen konkrete përmban mangësi të dukshme në analizën e këtij kriteri. Konkretisht, lidhur me proporcionalitetin e masës në drejtim të nevojës, rezulton se gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata e Lartë kanë vlerësuar se ka tri rreziqe ose ndryshe nevoja sigurimi (ku rreziku i kryerjes së veprave të tjera penale paraqitet në nivel jo të lartë), referuar kushteve të veçanta të përcaktuara në pikën 3 të nenit 228, ndërkohë që gjyqtari i apelit, megjithëse konkludon për një rrezik, vetëm atë të largimit, sërish e shikon masën e sigurimit personal "Arresti në burg" si proporcionale, njësoj me shkallën e parë. Nga ana tjetër, konkluzioni i gjykatave se kërkuesi paraqet rrezik të largohet, nuk i përgjigjet situatës së fakteve të çështjes, pasi kërkuesi ka respektuar masën e vendosur në një procedim tjetër, duke u treguar bashkëpunues. Po ashtu, edhe argumentet se ka rrethana nga të cilat krijohet vlerësimi se ka rrezik eminent që liria e pakushtëzuar e kërkuesit mundet të helmojë provat apo të kontribuojë në prishjen e tyre, nuk duket të jetë shteruese dhe në përputhje me dispozitat procedurale penale. Këto të fundit kanë përcaktuar se kur vihet në rrezik marrja e provave, masa e sigurimit caktohet me afat (*neni 245 i KPP-së*) dhe jo pa afat, siç ka ndodhur në rastin e kërkuesit.

16. Në kuadër të parimit të subsidiaritetit, që lidhet ngushtësisht me vlerësimin e cenimit të një të drejte substanciale, masa e sigurimit personal e arrestit në burg, që është caktuar ndaj kërkuesit, nuk ka qenë e *përshtatshme*. Fillimisht vëmë në dukje se, në zbatim të detyrimeve kushtetuese që burojnë nga neni 27 i Kushtetutës, KPP-ja parashikon qartësisht se "Arresti në burg" caktohet kur çdo masë tjetër është e papërshtatshme (*neni 230, pika 1*) si *extrema ratio* dhe se gjykata kur cakton këtë masë ka detyrimin të arsyetojë papërshtatshmërinë e masave të tjera (*neni 245, pika 1, shkronja "c'"*). Në rastin konkret, gjykatat e zakonshme nuk rezultojnë ta kenë përmbushur një detyrim të tillë, pasi në caktimin e masës së arrestit në burg ndaj kërkuesit nuk kanë arsyetuar për ekuilibrin që duhet të ekzistojë midis së drejtës substanciale të lirisë personale të kërkuesit dhe interesit për mbarëvajtjen e procedimit penal ndaj tij dhe përse masat e tjera të sigurimit, si ajo "Arresti në shtëpi" dhe "Garancia pasurore", e kërkuar edhe nga kërkuesi si zëvendësim *in meius* të masës së caktuar, nuk mund të përmbushnin qëllimin legjitim.

17. Duke mbajtur parasysh sa më sipër, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar sa duhet lidhur me caktimin e masës së arrestit në burg, ndërkohë që është kërkuar nga kërkuesi zëvendësimi i saj me një masë më të lehtë si ajo "Garancia pasurore". Me fjalë të tjera, nuk duket që gjykatat e zakonshme të kenë vlerësuar ndonjë masë sigurimi alternative përtej deklarimeve të thjeshta formale të tyre, pavarësisht kërkesave të kërkuesit, si dhe faktit se ai në një procedim tjetër kishte respektuar masën e detyrimit të paraqitjes të vendosur nga gjykatat, duke u treguar bashkëpunues. Gjithashtu, lidhur me arsyetimin e shumicës për kërkesën për zëvendësim të masës së sigurimit me një masë më të lehtë, dhe atë "Garancia pasurore", vlerësojmë se duke qenë se elementi kohë, siç referon shumica *(shih paragrafin 57 të vendimit),* nuk përbën element të konsoliduar në jurisprudencën e Gjykatës, pasi po kjo gjykatë, në një vendim të mëparshëm *(shih vendimin nr. 79, datë 12.11.2024, të Gjykatës Kushtetuese)*, kur ka trajtuar një masë sekuestro (masë kufizuese për pronën), ka vlerësuar edhe elementin kohë dhe jo vetëm momentin faktik kur ajo masë ishte caktuar, ndaj, shumica do duhej të kishte analizuar në të njëjtën qasje si vendimi i sipërcituar.

18. Duke mbajtur në konsideratë sa më lart, vlerësojmë se, në kushtet kur kriteret e mësipërme nuk janë analizuar mjaftueshëm ose në raport me nenin 17 të Kushtetutës nga gjykatat e zakonshme, vendimet e tyre konsiderohen stereotipa, me argumente të përgjithshme dhe që nuk përmbajnë fakte konkrete të cilat do të justifikonin caktimin e masës më të rëndë të sigurimit, atë "Arresti në burg". Po kështu, edhe Gjykata e Lartë, nëpërmjet një vendimi *de plano,* ka vendosur mospranimin e rekursit, duke i vlerësuar si të pabazuara pretendimet e kërkuesit dhe, për më tepër, ajo gjykatë duket se i ka kaluar barrën e provës atij, duke i kërkuar që të provojë ekzistencën e arsyeve që garantojnë dhënien e një mase më të lehtë për të.

19. Në këtë mënyrë, ne mendojmë se si procesi i caktimit të masës së sigurimit të arrestit në burg, ashtu dhe qëndrimi i shumicës, nuk kanë përmbushur qëllimin kushtetues të parandalimit të heqjes së pajustifikuar të lirisë personale. Për rrjedhojë, vlerësojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e lirisë personale, në raport me parimin e proporcionalitetit, është i bazuar.

20. Për të gjitha arsyet e mësipërme, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi ishte i bazuar, pasi masa e vendosur ndaj tij nuk ishte proporcionale, ndaj Gjykata duhej të kishte vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesës dhe në kuadër të parimit të subsidiaritetit duhej ta kthente çështjen për shqyrtim në Gjykatën e Lartë, e cila, në kuadër të rolit të saj subsidiar, duhej t'u kishte dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuesit me natyrë kushtetuese.

Anëtarë: Sonila Bejtja, Sandër Beci